



**MINISTRIA E ARSIMIT,  
SPORTIT DHE RINISË**

nr. 6145 prot  
dt. 05.06.2018

**FEDERATA E  
SINDIKATAVE TË  
ARSIMIT DHE SHKENCËS**

**SINDIKATA E  
PAVARUR E ARSIMIT TË  
SHQIPËRISË**

Sot, më datë 05 06, 2018, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në prani të palëve, nënshkruhet kjo Kontratë Kolektive Pune, ndërmjet:

- Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, MASR, përfaqësuar nga Ministri, Znj. Lindita Nikolla, nga njëra anë, dhe:
- Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë (FSASH), përfaqësuar nga Kryetari, Z. Arjan Dyrmishi, dhe
- Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë (SPASH), përfaqësuar nga Presidenti, Z. Nevruz Kaptelli, nga ana tjetër.

Palët nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive konfirmojnë se në fazën përgatitore për fillimin e bisedimeve për negociimin dhe nënshkrimin e Kontratës së re Kolektive të Punës, bazuar në nenet 163 e në vijim, të Ligjit nr. 7961 datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, pala punëmarrëse provoi identitetin e saj, përfshirë depozitimin në MASR të statuteve të secilës sindikatë, vendimet e Gjykatës së Tiranës, që i njeh ato si persona juridikë, treguesin e përfaqësueshmërisë si dhe Marrëveshjen ndërmjet FSASH dhe SPASH në kuadrin e Aleancës Sindikale, për t’u paraqitur si palë e vetme përpara punëdhënësit, të përfaqësuar nga dy kryetarët, për negociimin dhe nënshkrimin e Kontratës Kolektive të Punës.

Bazuar në sa më sipër, pala punëdhënëse, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, njohu Federatën e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës, FSASH dhe Sindikatën e Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, SPASH, si sindikatat më përfaqësuese në sektorin e arsimit parauniversitar dhe i fton ato për të filluar procesin e bisedimeve për hartimin dhe nënshkrimin e kësaj Kontrate Kolektive.

Në përfundim të procesit të bisedimeve, palët u dakordësuan të hartojnë Kontratën Kolektive të Punës me përmbajtjen si vijon.

**Neni 1**

**BAZA LIGJORE**

**1.1.** Kjo Kontratë Kolektive mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenet 50 dhe 51, në Konventat Ndërkombëtare të Punës, veçanërisht në Konventat nr. 87 dhe 98, në Ligjin nr. 7961 datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, Kreu XV “Kontrata Kolektive e Punës” dhe veçanërisht nenin 181, “Liritë sindikale – parimet”, përfshirë pikën 7, shkronjat a, b, c, ç, dhe pikën 8, sipas të cilës “Të drejtat sindikale, të përfituara në më shumë se dy kontrata kolektive

të njëpasnjëshme, nuk mund të kundërshtohen nga punëdhënësi”; në Ligjin nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës në tërësi dhe ato në fushën e arsimit në veçanti.

## **Neni 2**

### **FUSHA E ZBATIMIT TË KONTRATËS**

**2.1.** Kjo Kontratë Kolektive i shtrin efektet e saj mbi të gjithë personelin mësimor të punësuar në sistemin arsimor publik parauniversitar, përfshirë mësuesit e arsimit fillor, mësuesit e arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë.

**2.2.** Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive në nivel qendror, janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha nivelet e tjera që legjitimohen për nënshkrimin e kontratave kolektive në nivel vendor për arsimin parashkollor dhe arsimin profesional, në kuptimin që këto subjekte nuk mund të përfshijnë në kontratë më pak të drejta për punëmarrësit se sa legjislacioni shqiptar dhe kjo Kontratë Kolektive.

## **Neni 3**

### **KOHËZGJATJA E KONTRATËS**

**3.1** Kjo Kontratë Kolektive do të zbatohet nga data e nënshkrimit të saj deri më 31 dhjetor 2022.

## **Neni 4**

### **PUNËSIMI**

**4.1.** Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, të gjithë punonjësit që aktualisht kanë një vend pune në sistemin e arsimit parauniversitar, dhe që plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 57, pika 1, shkronja “b”, pika 2 dhe 3; neni 72, pika 5 të Ligjit nr. 69/2012 dhe nenin 4, pika 4 të kësaj Kontrate ruajnë statusin e të punësuarit me kontratë për një kohëzgjatje të pacaktuar. Këtë të drejtë e gëzon çdo i punësuar që aktualisht është brenda sistemit.

**4.2.** Anëtarë të sindikatave nënshkruese të kësaj kontrate konsiderohen vetëm ata të punësuar që janë deklaruar personalisht me shkrim, në mënyrë vullnetare, (sipas formatit të Deklaratës Personale), dhe që paguajnë kuotizacionin sindikal, sipas mënyrës dhe masës që përcaktohet në statutet e FSASH dhe SPASH.

**4.3.** Kriteret për ushtrimin e profesionit të mësuesit janë:

- a) Mësuesi i arsimit parashkollor, duhet të zotërojë diplomë universitare të ciklit të parë të studimeve universitare “bachelor”.
- b) Mësuesi i arsimit fillor, mësues i arsimit të mesëm të ulët dhe mësues i arsimit të mesëm të lartë, diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare si dhe të ketë marrë provimin e shtetit.
- c) Mësuesi i shkollave të mesme të profilizuara për muzikë, art dhe gjuhë të huaja, që jep lëndë profesionale, mësuesi i arsimit të orientuar dhe mësuesi që punon me nxënës me aftësi të kufizuara, duhet të zotërojë diplomë të ciklit të dytë të studimeve universitare.
- d) Diplomat e njëvlershme me diplomat që citohen në shkronjat a, b dhe c të sipërcituara përcaktohen me udhëzim të ministrit.

e) Kriteret e përcaktuara në shkronjat a, b dhe c të nenit 4, pika 3, janë të detyrueshme edhe për arsimin jopublik.

#### 4.4. Punësimet e reja në arsimin parauniversitar publik:

Në institucionin arsimor publik, përfshirë dhe atë parashkollor, pranimi dhe emërimi i mësuesit në një vend të lirë pune mbështetet në parimin e meritës dhe të drejtën për zgjedhjen e institucionit arsimor. Emërimi i mësuesit bëhet nga drejtori i institucionit arsimor, sipas renditjes në portalin “Mësues për Shqipërinë”. Procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune si dhe administrimi i portalit “Mësues për Shqipërinë”, përcaktohen me udhëzim të ministrit.

4.5. Personi që merret në punë për herë të parë pajiset nga punëdhënësi me Librezë Pune, e cila është unike për të gjithë të punësuarit, sipas modelit të përcaktuar nga organi kompetent.

4.6. Punëdhënësi nuk mund të zgjidhë kontratën e punës pa shkaqe të arsyeshme. Shkaqe të paarsyeshme konsiderohen ato që përmban neni 146, pika 1, shkronjat a, b, c, d dhe e, të Kodit të Punës.

Palët bien dakord që FSASH/SPASH, për anëtarët e tyre, të negociojnë me punëdhënësin për zgjidhjet që ofrojnë dispozitat e pikës 2 dhe 3 të nenit 146 të Kodit të Punës.

4.7. Zgjidhja e marrëdhënieve kontraktuale të punës nga punëdhënësi pa shkaqe të arsyeshme, është e pavlefshme. Në këtë rast, punëdhënësi detyrohet t’i paguajë dëmshpërblim punëmarrësit, sipas dispozitave ligjore e nënligjore në fuqi.

4.8. Kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, për zgjidhjen e marrëdhënieve kontraktuale të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë ndaj punëmarrësit këto afate njoftimi:

- a) Një muaj, për të punësuarit që kanë një vit punë.
- b) Dy muaj, për të punësuarit që kanë dy deri në pesë vjet punë.
- c) Tre muaj, për të punësuarit që kanë më shumë se 5 vjet punë.

Në mungesë të njoftimit të këtyre afateve, punëdhënësi është i detyruar t’i paguajë punëmarrësit pagën mujore që i korrespondon afatit të njoftimit, (neni 143 i Kodit të Punës).

4.9. Punëmarrësi fiton shpërblim për vjetërsinë, kur kontrata është zgjidhur nga punëdhënësi dhe marrëdhëniet e punës midis tyre kanë zgjatur jo më pak se tre vjet. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 145 të Kodit të Punës. Sindikatat nënshkruese të Kontratës Kolektive mbështesin anëtarët e tyre, që këtë shpërblim ta përfitojnë, duke negociuar me punëdhënësin ose duke e zgjidhur çështjen në rrugë gjyqësore.

4.10. Zgjidhja e menjëhershme e marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi ose punëmarrësi bëhet duke respektuar dispozitat e neneve 153 deri 156 të KP.

4.11. Punëdhënësi është i detyruar të ruajë vendin e punës:

- a) Për prindërit me raport lindjeje.
- b) Për punonjësit që nuk gëzojnë shëndet të plotë dhe këtë e vërtetojnë me raport mjekësor, për aq kohë sa zgjat paaftësia e përkohshme. Këtë të drejtë e përfitojnë edhe punëmarrësit që marrin leje për kujdes familjar, me ose pa të drejtë page, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

4.12. Në kuptimin e nenit 31, 33 dhe 92 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i punësuarit në arsimin parauniversitar mund t’i përfundojë marrëdhëniet e punës me kërkesën e tij ose të punëdhënësit, me kusht që i punësuarit të ketë plotësuar kushtet që përmbajnë dispozitat e mësipërme dhe t’i këtë lindur e drejta për pension të plotë pleqërie. Në këtë rast, për të mos shkaktuar çrregullime në procesin mësimor, sidomos në marrëdhënie me

nxënësit, si dhe për të mos rënduar padrejtësisht fondin e pagave, punëdhënësit i ndalohet që t'i ndërpresë marrëdhëniet e punës të punësuarit, në mënyrë të njëanshme, për shkak të plotësimit të moshës së pensionit, në 2 muajt e fundit të vitit shkollor.

## **Neni 5**

### **NDRYSHIMI I VENDIT TË PUNËS**

**5.1.** Sindikatat mbështetin kërkesat e anëtarëve të tyre të punësuar në arsim për ndryshimin e vendit të punës, me kusht që të përmirësohet pozita e punëmarrësit. Sindikatat, së bashku me kërkesën e të punësuarit, për ndryshimin e vendit të punës, i paraqitin punëdhënësit përkatës edhe mendimin e tyre me shkrim dhe të argumentuar, brenda muajit maj të çdo viti.

**5.2.** Miratimin ose mosmiratimin e kërkesës së punëmarrësit për ndryshimin e vendit të punës, punëdhënësi është i detyruar t'ia njoftojë me shkrim punëmarrësit 15 ditë para fillimit të vitit të ri shkollor, duke parashtruar edhe argumentet përkatëse.

**5.3.** Ndryshimi i vendit të punës me iniciativën e punëdhënësit, bëhet vetëm për raste të veçanta dhe konkretisht:

- a) për nevoja madhore në arsim, që lidhen me kërkesa urgjente për mësues me arsim përkatës në shkolla apo zona të caktuara brenda rrethit, ku si rezultat i mungesës së mësuesve me arsim përkatës, vihet në pikëpyetje dhe rrezikohet mësimdhënia;
- b) për t'u sistemuar në një shkollë tjetër, kur shkurtohet vendi i punës në shkollën e mëparshme. Kur ka vetëm një konkurrues për vendin e punës, sistemimi i mësuesit në shkollën e re bëhet pa iu nënshtruar procedurave të konkurrimit;
- c) kur ndryshimi i vendit të punës bëhet për shkaqet që përcaktohen në shkronjat "a" dhe "b" të këtij neni, transferimi nuk duhet të ndikojë në keqësimin e shëndetit të punëmarrësit, as në përkeqësimin e kushteve ekonomike, financiare dhe të jetesës. Në këto raste ndryshimi i vendit të punës nuk mund të zgjasë më shumë se 6 muaj;
- d) për gratë me fëmijë nën moshën tre vjeç, ndryshimi i vendit të punës nuk bëhet kur rruga vajtjeardhje zgjat më shumë se 30 minuta në këmbë, me përjashtim të rasteve kur transferimi bëhet me kërkesën e punëmarrëses ose është në favor të saj.

**5.4.** Si rregull, punëmarrësit i ndryshohet vendi i punës vetëm para fillimit të vitit mësimor, duke respektuar procedurat që përcakton Kodi i Punës dhe Kontrata Kolektive.

**5.5.** Në çdo rast, ndryshimi i vendit të punës bëhet vetëm brenda njësisë administrative në juridiksionin e njësisë arsimore përkatëse dhe duke mbajtur parasysh shkallën e kualifikimit, vjetërsinë në punë, rezultatet në punë dhe nivelin arsimor.

**5.6.** Urdhri për ndryshimin e vendit të punës duhet t'i jepet punëmarrësit me shkrim dhe i motivuar, 10 ditë para ekzekutimit të parashikuar.

**5.7.** Në rastet e ndryshimit të vendit të punës për mësuesit sindikalistë, anëtarë të FSASH/SPASH, me kërkesën e këtyre të fundit, punëdhënësi është i detyruar t'i vejë në dijeni ato për motivet e ndryshimit të vendit të punës dhe për pasojat juridike, ekonomike dhe sociale që vijnë në këtë rast.

**5.8.** Kur ka kundërshtime nga sindikata ose i interesuari, brenda 30 ditëve nga marrja e këtij njoftimi, palët duhet të bëjnë konsultime dhe të gjejnë zgjidhjet ligjore, në të kundërt, secila palë rezervon të drejtën t'i drejtohet Zyrës së Pajtitimit, ose Gjykatës, vendimet e të cilës janë të detyrueshme për palët.

**KOHA E PUNËS**

**6.1.** Në arsimin parauniversitar zbatohet java 5 ditëshe e punës, nga e hëna deri të premten. Për nevoja të procesit mësimor – edukativ dhe të aktiviteteve jashtëshkollore, përjashtimet bëhen me marrëveshje të veçantë midis punëdhënësit dhe punëmarrësit në nivelin e njësisë arsimore vendore ose të institucionit arsimor dhe seksioneve sindikale vendore.

**6.2.** Në arsimin bazë (klasa 1-9) dhe në arsimin e mesëm, koha javore e punës përbëhet nga dy komponentë:

a) Nga koha ditore gjatë së cilës punëmarrësi është në dispozicion të punëdhënësit. Në zbatim të kësaj kërkesë palët konfirmojnë se mësuesit e punësuar në arsimin bazë dhe në arsimin e mesëm paraqiten në shkollë 20 minuta para fillimit të mësimit dhe qëndrojnë në ambientet e shkollës derisa mbaron programi mësimor i turnit përkatës, por jo më shumë se 6 orë 60 minutëshe në ditë.

i. Përjashtimet bëhen me marrëveshje të posaçme midis MASR dhe FSASH/SPASH.

ii. Punëdhënësi në nivelin e institucionit arsimor është i detyruar që të krijojë kushte të përshtatshme për mësuesit, për t'iu mundësuar atyre që kohën e qëndrimit në institucion (shkollë) ta shfrytëzojnë në mënyrë aktive dhe në ambiente të përshtatshme.

b) Nga normat e punës mësimore javore dhe vjetore, për çdo cikël, të cilat vendosen me Udhëzim të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në konsultim me sindikatat nënshkruese të Kontratës Kolektive të Punës, dhe konsiderohen si pjesë e kësaj kontrate.

**6.3.** MASR merr përsipër që nëpërmjet konsultimeve me FSASH/SPASH të bjerë dakord për nxjerrjen e akteve normative të cilat të adresojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjatë problemin e ngarkesës mësimore javore në kushtet e uljes së përgjithshme të numrit të nxënësve, veçanërisht në zonat rurale.

Në zgjidhjen e këtij problemi, parimet bazë të jenë garantimi i të drejtës për arsimim të çdo fëmije, rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe garantimit të vendeve të punës të personelit të përhershëm mësimdhënës.

**6.4.** Ngarkesa mësimore javore për punonjësit mësimorë në arsimin parashkollor është 30 orë në javë.

**6.5.** Mësuesit që punojnë në ciklin e ulët dhe mësuesit që kanë klasë në kujdestari, u barasvlerësohet kjo punë me dy orë mësimore.

**6.6.** Orët mësimore që mësuesi zhvillon mbi normën e caktuar në Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, paguhet si orë suplementare.

**6.7.** Ngarkesa mësimore e mësuesve të cilësuar “invalidë pune” do të jetë në përputhje me vendimin e KMCAP.

**6.8.** Mësimdhënësit gëzojnë të drejtën për punë suplementare të pagueshme deri në 30% të ngarkesës mësimore.

**6.9.** Mësuesit e cilësuar “invalidë pune” nuk mund të ngarkohen me orë mësimore mbi normë.

**6.10.** Orët shtesë mbi normë për veprimtaritë mësimore-edukative në ditët e pushimit javor për realizimin e programit ose të aktiviteteve zyrtare që bëjnë njësitë arsimore vendore, do të paguhet sipas nenit 91, pika 3 e Kodit të Punës.

**6.11.** Koha e punës për të punësuarit e tjerë të përcaktuar në nenin 2 të kësaj Kontrate rregullohet me VKM.

**6.12.** Normat e punës mësimore edukative, përfshirë normat e veçanta dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar, janë sipas përcaktimit të bërë në Udhëzimet përkatëse të ministrit përgjegjës për arsimin.

Ndryshimet në këto udhëzime bëhen pas konsultimit me sindikatat partnere.

## **Neni 7**

### **KUSHTET E PUNËS**

**7.1.** Institucioni arsimor duhet t'u krijojë mësuesve kushte dhe mundësi për punë krijuese dhe të pavarur në procesin e mësimdhënies, përfshirë:

- a) lirinë profesionale në zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës;
- b) sigurimin e kushteve të mjaftueshme për mësimdhënie efektive;
- c) krijimin e mundësive për zhvillim profesional dhe punë kërkuese.

**7.2.** MASR dhe Sindikatat Partnere marrin përsipër, që në bashkëpunim me pushtetin vendor, bashkitë dhe njësitë administrative të krijojnë në të gjitha institucionet e arsimit publik (shkollat), për mësuesit dhe nxënësit, kushte pune bashkëkohore.

Në këto kushte përfshihen ruajtja, mirëmbajtja dhe ngrohja e objekteve shkollore, kushte të përshtatshme higjieno-sanitare në kopshte dhe shkolla, përfshirë mjetet e nevojshme për të siguruar higjienën vetjake, ujë në sasi të mjaftueshme, dhoma higjienike për gratë, WC me standard dhe numër të mjaftueshëm, si dhe krijimin e hapësirave të nevojshme që t'u mundësojnë mësuesve kushte normale për punë dhe studim gjatë orëve të qëndrimit në institucion.

**7.3.** Punëdhënësi merr masat e duhura për dhënie e ndihmës së shpejtë, siç përcaktohet në nenin 75 të Kodit të Punës.

**7.4.** MASR dhe FSASH/SPASH do të negociojnë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të mundësuar që të gjithë mësuesit, të përfitojnë falas ekzaminimin që kërkohet me Udhëzimin e përbashkët nr. 2 datë 25.6.2004, të dy dikastereve të cituara.

## **Neni 8**

### **KOHA E PUSHIMIT**

**8.1.** Koha e pushimit në sistemin e arsimit publik përbëhet nga pushimet javore dhe pushimet vjetore.

**8.2.** Pushimi javor është ditën e shtunë dhe ditën e diel.

**8.3.** Përcaktimi i kohës së pushimeve vjetore mbështetet në nenin 92, pika 2 të Kodit të Punës dhe në VKM nr. 220, datë 24.05.1994 "Për pushimin plotësues në sektorin e arsimit". Në bazë të këtyre dispozitave, pushimet vjetore për mësimdhënësit dhe drejtuesit e tyre përbehen nga 56 ditë pune, ku përveç pushimeve verore, përfshihen edhe ditët kur mësimi ndërpritet sipas programit mësimor vjetor.

- Për periudhën e verës koha e pushimit nuk mund të jetë më pak se 45 ditë kalendarike dhe nuk mund të ndërpritet më shumë se një herë.

- Pushimi vjetor për personelin ndihmës dhe personelin e shërbimeve është jo më pak se 4 javë kalendarike.

**8.4.** Për efekt të lejes vjetore, në kohën e punës llogaritet edhe koha e paaftësisë së përkohshme në punë.

**8.5.** Punëmarrësit anëtarë të sindikatave nënshkruese të kësaj Kontrate, në rast martese ose vdekjeje të bashkëshortit, të paraardhësve ose pasardhësve të tyre të drejtpërdrejtë, të motrave dhe vëllezërve, përfitojnë një pushim të paguar prej 5 ditësh.

**8.6.** Në rast sëmundjeje të rëndë të paraardhësve ose pasardhësve të drejtpërdrejtë, të vërtetuar me raport mjekësor, punonjësit e arsimit, anëtarë të sindikatave nënshkruese të kësaj Kontrate, përfitojnë deri në 10 ditë pune të papagueshme në muaj ose 120 ditë në vit.

## **Neni 9**

### **ZHVILLIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMI I MËSUESVE**

**9.1.** Institucioni arsimor planifikon zhvillimin profesional të mësuesve, sipas nevojave të tyre dhe në përputhje me politikat arsimore qendrore, vendore dhe të institucionit, përfshirë zhvillimin e brendshëm profesional, trajnimet, rrjetet profesionale, këshillimet dhe kurset afatshkurtra dhe afatgjata.

Zhvillimi i brendshëm profesional bëhet në nivel shkolle nëpërmjet këshillit të mësuesve dhe ekipeve lëndore.

**9.2.** Punëdhënësi merr përsipër trajnimin profesional të mësuesve sipas nenit 58 të Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për jo më pak se 3 ditë në vit.

**9.3.** Punonjësit arsimorë të institucioneve, që kanë nxënës me aftësi të kufizuara, certifikohen në programe trajnimi për trajtimin e këtyre nxënësve.

**9.4.** Kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve përcaktohen me Udhëzim të Ministrit, mbas konsultimit me sindikatat partnere.

## **Neni 10**

### **SISTEMI I PAGAVE DHE SHPËRBLIMEVE**

**10.1.** Mbështetur në Strategjinë e Sistemit Arsimor Parauniversitar dhe në Programet e MASR dhe Qeverisë, që konsiderojnë arsimin sektor prioritar, të dy palët bien dakord që të punojnë së bashku për të ndërtuar e zbatuar, nga viti në vit, një sistem pagash dhe shpërblimesh që mundëson një vlerësim më të mirë të figurës dhe punës së mësuesit dhe një motivim më të madh të tyre, të bazuar në angazhimin në procesin e reformimit e modernizimit të arsimit dhe të cilësisë së mësimdhënies.

**10.2.** Palët bien dakord që, në bazë të dispozitave të Kodit të Punës, të Kartës së Lirive dhe të Drejtave të Njeriut dhe të Kartës Sociale Evropiane, të garantojnë për të punësuarit në të gjithë nivelet e arsimit parauniversitar publik pagë të barabartë për punë të barabartë dhe profesion të njëjtë, pa asnjë dallim.

**10.3.** Pagat e punonjësve mësimorë dhe ndihmës në sistemin e arsimit parauniversitar janë sipas strukturës së pagave të miratuara në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave në fuqi.

**10.4.** Pala punëdhënëse konfirmon se, bazuar në nenin 1 të Ligjit nr. 8487, datë 13.05.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, në kuadrin e partneritetit social, në procesin e hartimit të buxhetit të çdo viti do të konsultohet dhe do të marrë mendimin e sindikatave nënshkruese të Kontratës Kolektive, përpara se propozimet përkatëse të dërgohen në Qeveri.

Në mënyrë të posaçme, MASR do të zhvillojë çdo vit konsultime me FSASH/SPASH për masën e rritjes së pagave, për ndërtimin e raporteve më të drejta midis pagës minimale dhe maksimale në sistemin publik të arsimit parauniversitar, të komponentit të pagës që ka të bëjë me përgatitjen dhe aftësimin profesional të mësuesve, si dhe me ndërtimin e një sistemi që inkurajon dhe motivon mësuesit që dallohen për rezultate më të mira në objektivin e arsimit cilësor, zgjidhje këto që vendosen e përballohen brenda kuotave të buxhetit të shtetit të aprovuar për këtë nivel arsimit.

**10.5.** Pala punëdhënëse pranon kërkesën e sindikatave që rritja vjetore e pagës për punonjësit e sistemit arsimor parauniversitar të negociohet çdo vit buxhetor.

**10.6.** Në bazë të nenit 21 të Kartës Sociale Evropiane për të drejtën e partnerëve socialë për informim dhe me qëllim që të luftohen me efikasitet shpërdorimet dhe korrupsioni në menaxhimin e buxhetit të arsimit, sidomos për pagat, shpërblimet, shpenzimet operative dhe investimet, punëdhënësi është i detyruar që të njohë përfaqësuesit kryesorë të Sindikatave Qendrore me të gjitha të dhënat përkatëse financiare, të burimeve njerëzore, etj. Ky detyrim qëndron edhe për partnerët në nivelin vendor.

**10.7.** Paga e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni është e garantuar për të gjithë të punësuarit në arsim në mënyrë definitive.

**10.8.** Kur mësuesit kryejnë orë mësimi mbi ngarkesën mësimore vjetore të përcaktuar me udhëzim të ministrit, orët suplementare u paguhen sipas dispozitave përkatëse të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

**10.9.** Punonjësit mësimorë, që punojnë larg vendbanimit të tyre, por që kthehen brenda ditës në vendbanim, përfitojnë një shtesë në formë shpërblimi mbi pagë. Masa e kësaj shtese është e shkallëzuar në vartësi të largësisë së qendrës së punës nga vendbanimi i mësuesit dhe përcaktohet me VKM në konsultim me sindikatat partnere.

**10.10.** Punëdhënësi paguan shpenzimet e udhëtimit vajtje – ardhje për mësuesit e sistemit parauniversitar që punojnë larg vendbanimit të tyre në distancën mbi 5 km dhe që kthehen brenda ditës në shtëpi. Vendbanim konsiderohet perimetri i qendrës urbane ose qendrës së njësisë administrative ku banon mësuesi.

**10.11.** Me autorizim me shkrim nga sindikatat nënshkruese të kësaj kontrate kolektive, mësuesit anëtarë të FSASH/SPASH, që dalin në pension, përfitojnë një deri në dy paga mujore neto shpërblim.

**10.12.** Punëdhënësi, bazuar në Marrëveshjen e datës 28 janar 1999 nga Qeveria Shqiptare dhe FSASH, iu njeh të drejtën e fituar sindikatave nënshkruese për shpërblim vjetor të mësuesve në sistemin e arsimit publik parauniversitar. Masa e shpërblimit caktohet me marrëveshje midis palëve.

## **Neni 11**

### **MBËSHTETJA E STRATEGJISË, REFORMIMIT DHE MODERNIZIMIT TË ARSIMIT**

**11.1.** Sindikatat nënshkruese të kësaj kontrate kolektive, konfirmojnë se arsimit cilësor publik dhe jopublik dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës do të jenë prioritet i punës së tyre, se mbështesin dhe përfshihen aktivisht në procesin e hartimit dhe zbatimit të Reformës së Sistemit Arsimor Parauniversitar, për reformimin dhe modernizimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, se vlerësojnë programin e Qeverisë që e konsideron arsimin si sektor prioritar, dhe ofrojnë bashkëpunimin e tyre për përdorimin me efektivitet, kundër çdo abuzimi, shpërdorimi apo korrupsioni në dëm të buxhetit të shtetit.

**11.2.** Nëpërmjet seminareve, tryezave, diskutimeve në këshillat sindikale e forumet sindikale, sindikatat do të zërthejnë aspekte të veçanta të Reformës së Sistemit Arsimor Parauniversitar, përfshirë arsimin cilësor, krijimin e shanseve të barabarta për të gjithë nxënësit, procesin e vlerësimit,



të motivimit, tekstet etj., duke e vënë theksin në njohjen dhe zbatimin e këtyre kërkesave nga mësuesit dhe anëtarët e sindikatave.

11.3. Sindikatat partnere bien dakord që të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre me punëdhënësin dhe me aktorë të tjerë të interesuar për arritjen e këtyre qëllimeve.

## **Neni 12**

### **ANGAZHIMI I PERBASHKËT PËR ULJEN E NUMRIT TË FËMIJËVE QË BRAKTISIN SHKOLLËN DHE ELIMINIMIN E PUNËS SË FËMIJËVE**

12.1. Të dy sindikatat e arsimit, FSASH e SPASH, angazhohen që, me mundësitë e tyre dhe me mbështetje të tjera, sidomos nga Federata Ndërkombëtare e Arsimit, EI, nga sindikatat homologe, etj., të bëjnë një punë të veçantë për uljen e numrit të nxënësve që braktisin shkollën dhe eliminimin e punës së fëmijëve.

12.2. Nëpërmjet trajnimeve të drejtuesve sindikalë dhe të anëtarëve të sindikatave, si dhe nëpërmjet formave të tjera të punës konkrete në shkolla e në komunitet, ato do të synojnë për rritjen e numrit të mësuesve të angazhuar në një punë të veçantë me nxënësit që braktisin shkollën ose që janë në rrezik për ta braktisur atë, duke krijuar për ta një mjedis më tërheqës dhe më prindëror dhe duke pasur si objektiv eliminimin e punës së fëmijëve.

12.3. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, duke e patur si një ndër prioritetet e strategjisë së saj, mbështet këtë angazhim dhe siguron gatishmërinë e Institucioneve Arsimore për veprime të përbashkëta, duke nxitur edhe përfshirjen e organizmave të nxënësve dhe prindërve që veprojnë në shkolla.

12.4. Me propozimin e kryesive të sindikatave nënshkruese të Kontratës Kolektive, njësitë arsimore vendore shpërblejnë mësuesit që janë të angazhuar drejtpërdrejt dhe kanë rezultate të matshme për uljen e numrit të nxënësve që braktisin shkollën dhe eliminimin e punës së fëmijëve.

## **Neni 13**

### **LIRITË DHE TE DREJTAT SINDIKALE**

13.1. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë tërheq vazhdimisht mendimin e sindikatave nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive në procesin e hartimit të akteve ligjore e nënligjore që lidhen me reformën në arsim, me marrëdhëniet e punës, pagat, shpërblimet, kushtet e punës, etj.

13.2. Sindikatat nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive pajisen nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me urdhrat, udhëzimet dhe aktet e tjera të nxjerra prej saj.

13.3. Për të garantuar të zgjedhurit në vendet drejtuese sindikale në kryerjen e detyrës së tyre, përfshirë kryetarin, nën/kryetarin dhe sekretarin e Këshillit Sindikal të rrethit, si dhe kryetarët e këshillave sindikale në shkolla, punëdhënësit i ndalohej t'i largojë ata nga puna, ose t'u ndryshojë vendin e punës, pa marrë më parë pëlqimin me shkrim të Kryesisë së SPASH e FSASH, përveç rasteve kur vërehen shkelje të ligjit ose të Kontratës Kolektive të Punës.

13.4. Drejtuesve të seksioneve sindikale në njësitë arsimore vendore të secilës sindikatë nënshkruese të Kontratës Kolektive, për t'u mundësuar marrjen me veprimtari sindikale, mbështetur në nenin 181, pika 7 e Kodit të Punës, u reduktohet ngarkesa mësimore javore, nga 5 deri në 10 orë në javë, si rregull, sipas numrit të anëtarësisë me kuotizacion.

Seksioneve sindikale që kanë më shumë se 600 anëtarë, u reduktohet norma mësimore javore edhe me 6-8 orë në javë.

Masa konkrete e reduktimit të normës mësimore javore për çdo drejtues seksioni, bazuar në kriteret e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, vendoset nga secila sindikatë qendrore dhe u njoftohet njëjësive arsimore vendore në fillim të çdo viti mësimor.

Titullarët e sindikatave qendrore përgjigjen për zbatimin me korrektësi të kësaj dispozite dhe për shfrytëzimin me efektivitet të kohës së punës që u është vënë në dispozicion drejtuesve sindikalistë vendorë. Ata mund të anulojnë në çdo kohë autorizimin e tyre për uljen e ngarkesës mësimore për ata drejtues sindikalë vendorë që nuk e justifikojnë këtë lehtësi që u bëhet.

**13.5.** Me kërkesën e FSASH/SPASH, të zgjedhurve në kryesitë e sindikatave në njësitë arsimore vendore dhe këshilli sindikal në nivel shkolle, u sigurohet leje e pagueshme për të marrë pjesë në veprimtaritë sindikale lokale, kombëtare e ndërkombëtare. Kërkesa i paraqitet punëdhënësit përkatës nga kryesitë e seksioneve sindikale vendore, të paktën 3 ditë para aktivitetit.

**13.6.** Me kërkesën e kryesive të FSASH/SPASH, Drejtoria Arsimore e Qytetit Tiranë vë në dispozicion të tyre, për t'u marrë me veprimtari sindikale, nga një mësues për secilën sindikatë me ngarkesë mësimore javore të reduktuar, duke i ngarkuar këta mësues me jo më shumë se 10 orë mësimi në javë.

**13.7.** Në pajtim me nenin 181, pika 6 e Kodit të Punës, të zgjedhurit në organet sindikale në qendër e në njësitë arsimore vendore, me mbarimin e mandatit, kanë të drejtë për t'u rikthyer në punë në vendin dhe profilin e tyre.

**13.8.** Sindikatat nënshkruese të kësaj Kontrate Kolektive, me kërkesën e tyre, duhet të njihen me të gjithë treguesit ekonomik-financiar në nivel qendror dhe lokal.

**13.9.** Dita e Mësuesit (7 Marsi) dhe Dita Ndërkombëtare e Mësuesve (5 Tetori), do të jenë në të gjithë vendin ditë veprimtarish kushtuar këtyre festave.

**13.10.** Veprimtaritë sindikale zhvillohen në mjediset e shkollës, pa dëmtuar procesin mësimor. Seksionet dhe Këshillat Sindikale kanë të drejtë të shpërndajnë dhe publikojnë në mjediset e institucionit arsimor, njoftime, programe, objektiva, përfshirë Kontratën Kolektive dhe dokumente të tjera të tyre.

**13.11.** Punëdhënësi në nivel institucioni arsimor vë në dispozicion të punëmarrësit një kopje të Kodit të Punës dhe një kopje të Kontratës Kolektive të Punës.

**13.12.** Kryetarëve të këshillave sindikale në shkolla, që përfaqësojnë më shumë se 15 anëtarë, nuk u caktohet klasë në kujdestari.

**13.13.** Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë u siguron dy sindikatave qendrore, mjedise pune dhe pajisje për zhvillimin normal të veprimtarisë së tyre, ndërsa njësitë arsimore vendore duhet t'u sigurojnë ambiente dhe pajisje pune seksioneve sindikale të FSASH dhe SPASH.

**13.14.** Për të lehtësuar pjesëmarrjen e kryetarëve të seksioneve sindikale të rretheve në mbledhjet e këshillave drejtuese qendrore të tyre, për 4 (katër) mbledhje në vit, njësitë arsimore vendore, mbulojnë shpenzimet e udhëtimit dhe dietat, mbi bazën e vërtetimeve me shkrim të lëshuara nga kryesitë e sindikatave qendrore.

**13.15.** Punëdhënësi, bazuar në nenin 117/2 të Kodit të Punës, vetëm me autorizim me shkrim, nëpërmjet Deklaratës Personale të Anëtarësisë, që përbën edhe autorizimin personal të çdo anëtari të sindikatave nënshkruese të kontratës kolektive, zbret çdo muaj nga listë pagesat, kuotizacionin sindikal të cilin e xhiron në llogaritë përkatëse të secilës sindikatë ku është i anëtarësuar punëmarrësi.

Autorizimi/Deklarata Personale e Anëtarësisë, për zbritjen e kuotizacionit sindikal mund të shfuqizohet në çdo kohë nga punëmarrësi me njoftim me shkrim në sindikatën përkatëse dhe tek punëdhënësi.

Sindikatat njoftojnë me shkrim, në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate, njësitë arsimore vendore për shumën fikse mujore të kuotizacionit sindikal për anëtarët e tyre, si dhe numrin e llogarisë bankare përkatëse ku do bëhet xhirimi. Ky njoftim bëhet sa herë që ka ndryshime të masës së kuotizacionit.

Zbritja nga paga e kuotizacionit sindikal, sipas nenit 117, pika 2 të Kodit të Punës, mund të bëhet edhe për sindikata të tjera në arsimin publik parauniversitar, të cilat plotësojnë kërkesat e Nenit 163, pika 3, e Kodit të Punës, si dhe kërkesat e neneve 13.15 dhe 14.5 të kësaj kontrate.

## **Neni 14**

### **ZBATIMI I KONTRATES KOLEKTIVE NË NIVELIN VENDOR**

**14.1.** Për arsimin parashkollor lidhen kontrata kolektive midis titullarëve të njësive bashkiake dhe seksioneve sindikale vendore.

**14.2.** Dispozitat e kësaj kontrate kolektive janë të detyrueshme për njësitë arsimore vendore dhe institucionet arsimore në sektorin e arsimit parauniversitar.

**14.3.** Titullarët e njësive arsimore vendore dhe kryesitë e seksioneve sindikale të FSASH/SPASH, në kuadër të partneritetit social, zhvillojnë midis tyre takime periodike mbi problematika që lidhen me ecurinë normale të procesit mësimor, më cilësinë e mësimdhënies, me zbatimin e dispozitave të kontratës kolektive, veçanërisht zbatimin e të drejtave sindikale, mbrojtjen social-ekonomike të sindikalistëve, transportit, kushtet e punës dhe të pushimit, etj.

**14.4.** Njësitë arsimore vendore dhe Seksionet Sindikale të FSASH/SPASH duhet të formalizojnë dokumentacionin që pasqyron marrëdhëniet midis tyre. Për këtë:

a) Seksionet Sindikale të FSASH/SPASH depozitojnë në njësitë arsimore vendore dokumentacionin që vërteton anëtarësinë sindikale, Deklaratat Personale të Anëtarësisë.

- Anëtarësia sindikale me lista kolektive është e papranueshme.

- Deklaratat Personale të anëtarësisë sindikale të çdo mësuesi janë të përhershme, derisa i interesuari nuk e ka tërhequr anëtarësimin me kërkesë me shkrim.

- Për vërtetësinë e Deklaratave Personale të Anëtarësisë sindikale kryetarët e seksioneve sindikale mbajnë përgjegjësi ligjore.

- Punëdhënësit i ndalohet me ligj ndërhyrja në procesin dhe procedurat e anëtarësisë sindikale.

b) Dokumentacioni i anëtarësisë sindikale ruhet në arkivin e çdo njësie arsimore vendore. Mbi bazën e tij bazohet njohja nga punëdhënësi e përfaqësueshmërisë sindikale si dhe kryhen veprimet nga sektorët e financës të njësive arsimore vendore për zbritjen e kuotizacionit sindikal dhe xhirimin e tij në mënyrë periodike në favor të FSASH/SPASH.

## Neni 15

### ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

**15.1.** Palët bien dakord që kur Kontrata Kolektive nuk zbatohet ose shkelet nga njëra palë, do të bëhen përpjekje të përbashkëta që mosmarrëveshja të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet rrugës së bisedimeve dypalëshe. Nëse kjo nuk arrihet, pala e dëmtuar i drejtohet Gjykatës, duke kërkuar zbatimin e pikës 2,3 dhe 4 të nenit 170 të Ligjit nr. 7971, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe dëmin e shkaktuar.

**15.2.** Për rastet kur vërtetohen shkelje të dispozitave të kësaj kontrate, keqinterpretim apo keqzbatim në dëm të një apo disa sindikalistëve, pala punëmarrëse do të ndjekë procedurën e mëposhtme për zgjidhjen e tyre:

- a) Të punësuarit që kanë ankesa lidhur me shkeljen e të drejtave të tyre të garantuara nga kontrata kolektive dhe legjislacioni i marrëdhënieve të punës, fillimisht, nëpërmjet sindikatës ku bëjnë pjesë, duhet ta diskutojnë çështjen me punëdhënësin e institucionit arsimor.
- b) Nëse ankesa nuk zgjidhet me mirëkuptim sipas pikës 1 të këtij neni, i interesuari ose sindikata i drejtohet me shkrim titullarit të njësisë arsimore në territorin e së cilës ka lindur ankesa.
- c) Në parashtrimin e ankesës duhet të përfshihen: emri i të punësuarit, paraqitja e fakteve, përcaktimi i nenit të shkelur në kontratë me referencat përkatëse, si edhe shkeljet e akteve ligjore ose nënligjore.
- d) Njësia arsimore vendore, brenda 15 ditëve shqyrton ankesën dhe komunikon vendimin me shkrim për ankuesin.
- e) Ankuesi, brenda një afati 30 ditor mund ta apelojë vendimin e titullarit të njësisë arsimore vendore në MASR.
- f) Nëse pas kësaj procedure, konflikti nuk gjen zgjidhje, pala e interesuar, me mbështetjen e sindikatës, i drejtohet Gjykatës.

## Neni 16

### DETYRIMET DHE SANKSIONET

**16.1.** Palët kontraktuese janë të detyruara të përmbushin dhe respektojnë detyrimet që lindin nga Kontrata, duke respektuar kërkesat dhe duke zbatuar zgjidhjet që përmbajnë nenet 169 deri 172 të Kodit të Punës.

**16.2.** Pala që shkel dispozitat e kësaj kontrate në nivelin qendror ose vendor duke i shkaktuar dëm material ose moral palës tjetër, detyrohet të zhdëmtojë palën e dëmtuar sipas përcaktimeve që bëhen në pikën 1-7 të nenit 202 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

**16.3.** Në rast të thyerjes së disiplinës në punë, dëmtimit të rëndë ose të përsëritur të pasurisë së institucionit, punëmarrësve u jepen këto masa disiplinore:

- a) Qortim.
- b) Vërejtje.
- c) Paralajmërim për largim nga puna.
- d) Zbritje në detyrë ose zbritje në një cikël më të ulët arsimi për 6 muaj.

